



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE ✓

Nr. 8094

Tirane, date 15.12./2015

Drejtuar: ZOTIT MUSTAFA PIRRAÇI
SHOQERIA "BATRA BMB - 2008" SHPK
BANESE PRIVATE, KRASTE MARTANESH, BULQIZE

DIBER

Për njoftim: Z. ARDIAN MAÇI, DREJTOR I PERGJITHSHEM
QENDRA KOMBETARE E LICENCIMIT

TIRANE

Z. VIKTOR DODA, DREJTOR I PERGJITHSHEM
SHERBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR
RRUGA E KAVAJES NR.153

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi revokimin e lejes nr. 1702 date 23.05.2014

I nderuar zoti Pirraçi,

Shoqëria "Batra BMB - 2008" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te kërkim - zbulimit nr.1702 date 23.05.2014, për mineral kromi, ne Kraste Martanesh, Bashkia Bulqize, te Qarkut Diber.

Nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ne mënyre te përsëritur dhe kohet e fundit me shkresën nr. 1545 date 02.11.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 7189 date 03.11.2015 është propozuar revokimi i lejes nr.1702 date 23.05.2014, sepse nuk janë kryer pagesat e garancive financiare te programit minimal te punës dhe rehabilitimit te mjedisit ne përputhje me pikën 1 e pikën 2, te nenit 31 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas pikës 5 e pikës 6 te nenit 30 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar duhet te ishin kryer pagesat e garancive financiare për programin minimal dhe rehabilitimin e mjedisit brenda 30 ditëve nga data e miratimit te lejes. Ne piken 10 te nenit 30 te ligjit qe cituam me sipër përcaktohen se leja revokohet automatikisht ne rast se nuk paraqitet dokumentet qe vërtetojnë pagesat e garancive për programin minimal dhe rehabilitimin e mjedisit brenda afatit te përcaktuar qe është 30 dite nga data e miratimit te kësaj leje.

Propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për revokim te lejes nr.1702 date 23.05.2014 është i mbështetur ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ju keni shkelur germen "ç" te pikës 1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, qe është shkelje ligjore për te cilën një leje minerare revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, **ju njoftojmë se është marre vendimi i revokimit te lejes nr.1702 date 23.05.2014, për mineral kromi, ne Kraste, Martanesh, Bashkia Bulqize, te Qarkut Dibër.**

Ne zbatim te pikës nr.7 te nenit 13 dhe nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e lejes se kërkim - zbulimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Kundër këtij vendimi behet ankim ne gjykatën administrative, sipas legjislacionit ne fuqi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

